FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 166 — 26 dhjetor — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 903, datë 12.12.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar……	9083
Vendim i GJK nr. 54, datë 13.12.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 514, datë 14.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr. 777, datë 24.10.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 1, datë 22.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë……	9083
Vendim i GJK nr. 55, datë 18.12.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër……	9087

VENDIM
Nr. 903, datë 12.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 19 të kreut XXXIV të lidhjes bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë e Tiranës, të bëhet 300 (treqind) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1150 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 54, datë 13.12.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Xhezair Zaganjori	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 25.9.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 25 Akti që i përket:

KËRKUESE: Sherife Gega, përfaqësuar nga Idajet Beqiri me deklarim.

SUBJEKTI INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme.

OBJEKTI: shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 514, datë 14.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr. 777, datë 24.10.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 1, datë 22.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11/2, 18, 23, 41/1, 42, 43, 131f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori; përfaqësuesin e kërkueses që kërkoi pranimin e kërkesës; u njoh me materialin e dërguar me shkrim nga subjekti i interesuar, i cili kërkoi pranimin e pjesshëm të kërkesës, konkretisht vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuesja është bashkëpronare e një trualli të ndodhur në Tiranë. Ngjitur me këtë truall është bërë një ndërtim, i cili është zgjatur duke përfshirë edhe truallin në pronësi të kërkueses. Ky veprim është bërë mbi bazën e një deklarate të firmosur para noteres nga i vëllai i kërkueses, F.G, i cili ka pasur prokurë përfaqësimi për të gjithë bashkëpronarët.

2. Kërkuesja ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me pretendimin se firma e vëllait të saj, F.G, është e falsifikuar. Ky pretendim është mbështetur edhe nga i vëllai i saj.

3. Prokuroria pas hetimeve të zhvilluara, me datë 16.1.2007, ka vendosur: "Pushimin e çështjes, pasi fakti nuk ekziston."

4. Kundër këtij vendimi, kërkuesja ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 514, datë 14.6.2007, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesës së kërkueses Sherife Gega si të pabazuar në ligj dhe prova."

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 777, datë 24.10.2007, ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit."

6. Mbi rekursin e kërkueses, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 12.12.2008, ka vendosur: "Dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësim të praktikës gjyqësore, lidhur me interpretimin e nenit 329/1 të KPP-së në rastet kur vendimi i pushimit të procedimit penal është marrë në bazë të nenit 328/1, germa "a", pra kur del qartë se fakti nuk ekziston."

7. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, datë 22.11.2010, kanë vendosur: "Mospranimin e rekursit për shkak të mosrespektimit të dispozitave që lidhen me formën e paraqitjes së rekursit."

8. *Kërkuesja* pretendon se procesi i zhvilluar në të gjitha shkallët ka qenë i parregullt, pasi:

8.1 Gjykatat nuk kanë vlerësuar siç duhet faktet dhe nuk kanë kërkuar riekspertim të firmës së F.G, pasi ka pasur dy ekspertime të kundërta dhe gjykata duhet të kishte urdhëruar një të tretë.

8.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të kishte vendosur rihetim të çështjes nisur edhe nga deklarata e përsëritur e F.G për mosnënshkrimin e aktit.

8.3 Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatë së Lartë është antikushtetues, sepse, pasi Kolegji Penal e kishte kaluar çështjen në seancë gjyqësore, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkaqe formale (nuk ishte nënshkruar nga mbrojtësi).

9. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në parashtrimet e tij dërguar me shkrim, parashtroi:

9.1 Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk kanë elementë antikushtetuese, ato janë në përputhje me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës;

9.2 Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është antikushtetues, pasi kërkuesja ka paraqitur rekursin brenda afatit ligjor, por pa firmën e mbrojtësit, mangësi e cila nuk duhet të kishte çuar në mospranimin e rekursit, por në njoftimin nga ana e sekretarisë gjyqësore për plotësimin e mangësisë, sipas jurisprudencës së vazhdueshme të Gjykatës Kushtetuese. Kjo ka bërë që kërkueses t'i mohohet e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, ky vendim duhet shfuqizuar.

II

A. Mbi pretendimin për cenimin e të drejtës së ankimit/aksesit në Gjykatën e Lartë

10. Kërkuesja pretendon se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke mos marrë në shqyrtim rekursin e saj vetëm për shkak se ai nuk ishte firmosur nga mbrojtësi i saj, kanë cenuar të drejtën për t'iu drejtuar asaj Gjykate me ankim. Një gjë e tillë ka sjellë si pasojë një proces të parregullt para Gjykatës së Lartë dhe për këtë arsye, vendimi i Kolegjeve të Bashkuara duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

11. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së ankimit në Gjykatë të Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar. Neni 31/ç i Kushtetutës parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Neni 42/1 i Kushtetutës parashikon: *"Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor"*. Neni 43 i Kushtetutës parashikon: *"Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe."*

12. Në funksion të këtyre dispozitave kushtetuese, Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP), nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë *(shih vendimin nr. 21/2006 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat e gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale *(shih vendimin nr. 5/2008 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Gjykata vlerëson se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimi, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Fjalia e parë e nenit duhet lexuar së bashku me fjalinë e dytë. Neni 435/2 i KPP-së ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Rekursi është akti procedural, në të cilin parashtrohen shkaqet, për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në atë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale *(shih vendimin nr. 38/2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP). Në situatën në të cilën kërkuesja ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së, si dhe duke ditur se rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej saj, ajo nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i saj të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të kërkueses, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs, i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i saj. Kolegji Penal, pasi ka shqyrtuar paraprakisht rekursin në dhomë këshillimi, ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara, pasi kanë hapur seancën gjyqësore, pra pasi kishte filluar debati gjyqësor, kanë konstatuar mosfirmosjen e rekursit nga mbrojtësi i kërkueses, si një nga kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së. Gjykata çmon se, në vështrim të garantimit të standardit të ankimit në një gjykatë më të lartë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e kanë interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe nga fjalia vijuese e kësaj dispozite procedurale. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese rezulton se as Kolegji Penal e as Kolegjet e Bashkuara nuk e kanë vlerësuar paraprakisht detyrimin e sekretarisë gjyqësore përkatëse dhe veprimet e saj për plotësimin e kërkesës formale për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi i kërkueses. Mangësitë formale duhet të konstatohen para kalimit të çështjes në seancë dhe për riparimin e tyre ngarkohet me ligj sekretaria gjyqësore.

16. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i saj, i ka cenuar asaj të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 dhe 43 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

B. Për pretendimet e tjera

17. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Tiranë duhet të kishin urdhëruar riekspertim të vërtetësisë së firmës së vëllait të saj F.G dhe rihetim të çështjes në tërësi, me qëllim nxjerrjen e së vërtetës së firmës së F.G.

18. Gjykata, në lidhje me pretendimet e tjera të kërkueses, vlerëson se ato kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit material dhe vlerësimin e fakteve dhe provave nga ana e gjykatave të zakonshme. Në jurisprudencën e saj, Gjykata e ka ripohuar vazhdimisht se mënyra e vlerësimit të provave dhe, në parim, mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme dhe jo i juridiksionit kushtetues *(shih vendimet nr. 23/2011, nr. 106/2001 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

19. Në përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet si antikushtetues, pasi i ka mohuar kërkueses të drejtën për të ushtruar akses/ankim në një gjykatë më të lartë, parashikuar nga neni 42 dhe 43 i Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 1, datë 22.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Xhezair Zaganjori.

VENDIM
Nr. 55, datë 18.12.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 30.10.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Zana Dema

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuesja, me profesion notere, ka redaktuar tri akte përfaqësimi, në data të ndryshme në vitin 2004, me titull “Prokurë e posaçme”. Rezulton se me anë të këtyre akteve shtetasit N.P., M.P., D.P., L.P., F.P., kanë emëruar si përfaqësues dy të afërmit e tyre, përkatësisht shtetasit V.N., dhe GJ.P., që të vepronin në emër të tyre për të çelur trashëgiminë, nga e cila atyre u buronin të drejta pronësie, të vepronin për njohjen e kësaj të drejte pronësie dhe kthimin e kompensimin e saj në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lezhë. Gjithashtu, shtetasve V.N. dhe GJ.P. iu është dhënë tagër e kompetenca të plota që, në emër e për llogari të të përfaqësuarve, të veprojnë për dorëzimin e dokumenteve përkatëse në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP) Lezhë, të tërheqin dokumentet e pronësisë, të bëjnë shitje të kësaj toke në Zyrën e Noterisë Lezhë, si dhe të kryejnë veprimet përkatëse në ZRVPP Lezhë, si palë shitëse.

2. Përfaqësuesit e emëruar, shtetasit V.N. dhe GJ.P., kanë kryer transaksione dhe kanë shitur pronën te shtetasi A.C., i cili më pas e ka shitur të njëjtën pronë, me anë të dy kontratave të veçanta, te përfaqësuesit e emëruar të pronarëve të tokës, shtetasit V.N. dhe GJ.P.

3. Prokuroria, mbi bazën e materialeve të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, ka filluar procedim penal ndaj kërkueses, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP). Sipas konkluzioneve të prokurorisë, pronarët e tokës nuk kanë pasur dijeni për aktet e përpiluara të sipërcituara, nuk kanë marrë pjesë në përpilimin e tyre dhe në këto akte nuk është pasqyruar vullneti i tyre.

4. Me vendimin nr. 22, datë 28.1.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, kërkuesja është deklaruar e pafajshme në lidhje me kryerjen e veprës penale të "shpërdorimit të detyrës".

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 323, datë 25.11.2009, ka vendosur: "ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 28.1.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; deklarimin fajtore të kërkueses për kryerjen e veprës penale të ' shpërdorimit të detyrës', të parashikuar nga neni 248 i KP-së dhe dënimin e saj me 6 muaj burgim dhe 300 000 lekë gjobë; urdhërimin e kërkueses të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës pranë Qarkut Shkodër dhe vënien e saj në provë për dy vjet, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me kusht të moskryerjes së asnjë vepre tjetër penale gjatë kohës së provës; heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vjetësh".

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-7, datë 2.2.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit.

7. *Kërkuesja* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2012-7, datë 2.2.2012 të Gjykatës së Lartë me pretendimin se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht ajo ka pretenduar se:

7.1 Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër *nuk është i arsyetuar*, është kontradiktor dhe alogjik pasi nuk analizohen elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës;

7.2 Është shkelur *parimi i barazisë së armëve, paanësisë në gjykim dhe të drejtës së mbrojtjes* për arsye se Gjykata e Apelit nuk është treguar e paanshme në vlerësimin e provave dhe e ka bazuar vendimin e saj në prova të mbledhura në mënyrë të jashtëligjshme;

7.3 Është cenuar *e drejta e aksesit* në Gjykatën e Lartë për shkak se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka pranuar rekursin, megjithëse janë respektuar kërkesat ligjore për përpilimin e përmbajtjen e tij.

8. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

II

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

9. Sipas kërkueses, vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është i arsyetuar, është kontradiktor dhe alogjik pasi nuk analizon elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale të "shpërdorimit të detyrës". Ajo ka argumentuar se në vendim nuk përmendet asnjë provë me fuqi të plotë provuese e bindëse që të provojë fakte me vlerë juridike për akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe nuk analizohet cilat janë veprimet apo mosveprimet e kërkueses që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës.

10. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta apelojnë këtë vendim, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih*

vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Kodi i Procedurës Penale (KPP) parashikon se vendimi penal arsyetohet, ndryshe është i pavlefshëm (neni 112/3). Sipas nenit 383 të KPP-së, një vendim penal duhet të përmbajë parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit. Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues.

13. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Arsyetimi i një vendimi gjyqësor duhet të përmbajë jo vetëm analizën e provave që pranohen, por edhe arsyet e mospranimit të provave të tjera, të jetë dinamik në funksion të dhënies së drejtësisë substanciale, racional dhe jo arbitrar, i plotë në përmbajtje dhe të ketë një rrjedhë logjike të kuptueshme. Në arsyetimin e vendimit, çdo kalim argumentues, nga fakti provues (prova) tek elementi ligjor që duhet provuar, duhet të justifikohet qartazi nga gjyqtari, duke qenë ky një proces vlerësimi mbi bazën e të cilit krijohet bindja e brendshme e gjyqtarit.

15. Gjykata vë në dukje, me këtë rast, se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërish të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Midis arsyetimit dhe legjitimitetit të vendimit ekziston një lidhje e ngushtë, prandaj, nëse arsyetimi mungon ose ka të defekte të tilla që tejkalojnë kufijve e logjikës juridike, kjo passjell, nga njëra anë, cenim të vetë legjitimitetit të vendimit gjyqësor dhe njëkohësisht, nga ana tjetër, edhe cenim të parimit të sigurisë juridike.

16. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër përmban, në pjesën arsyetuese, përmbledhjen e rrethanave të çështjes, bazën ligjore mbi të cilën mbështetet pjesa urdhëruese e vendimit (nenet 30/1; 35/1; 59 dhe 248 të KP-së), dispozitivin, por jo një analizë të provave në drejtim të evidentimit të elementëve të veprës penale. Sipas nenit 248 të KP-së përbën shpërdorim të *detyrës "Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë (…)"*.

17. Duke iu referuar interpretimit literal të dispozitës dhe praktikës gjyqësore, elementet objektive të veprës penale të "shpërdorimit të detyrës" janë: a) kryerja ose moskryerja e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin; b) veprimet apo mosveprimet përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës; c) veprimet ose mosveprimet kryhen nga një person që ushtron funksione publike; d) veprimet apo mosveprimet i kanë sjellë personit ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale ose kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë. Ndërsa, për sa i përket plotësimit të elementit subjektiv të veprës penale të "shpërdorimit të detyrës" kërkohet

domosdoshmërish ekzistenca e dashjes së drejtpërdrejtë. Nisur nga qëndrimi që ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë për dashjen e drejtpërdrejtë, si element subjektiv i veprës penale (*shih vendimin nr. 358, datë 9.7.2008 të Gjykatës së Lartë*), në rastin konkret dashja e drejtpërdrejtë evidentohet në këto tre aspekte: a) dijenia nga ana e kërkueses që veprimet ose mosveprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës; b) dëshira e kërkueses për t'i kryer këto veprime ose mosveprime; dhe c) kryerja e veprimeve ose mosveprimeve nga kërkuesja për përfitime materiale ose jomateriale të padrejta ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

18. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit Shkodër, në arsyetimin e vendimit, nuk ka analizuar elementët e veprës penale dhe më konkretisht, anën subjektive të saj. Kjo gjykatë, pasi ka vlerësuar rezultatin provues të aktit të ekspertimit, ka konkluduar se nënshkrimet e porositësve në prokurë nuk janë nënshkrimet origjinale të tyre, duke e konsideruar të konsumuar veprën penale të "shpërdorimit të detyrës". Ajo është mjaftuar me përfundimin se kërkuesja "ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen ligjore të detyrës së noterit dhe ky veprim i saj ka sjellë pasoja në dëm të shtetasve të interesuar", pa analizuar elementët subjektivë të veprës penale dhe pa verifikuar ekzistencën tyre. Detyrë e gjykatës, në këtë rast, ka qenë të vlerësonte provat, sipas kritereve ligjore, duke shpjeguar në arsyetim rezultatet e arritura provuese mbi bazën e të cilave të vërtetohej ekzistenca e elementëve objektivë dhe subjektivë të veprës penale. Pikërisht ky proces vlerësimi, i pasqyruar në vendim, përbën thelbin e arsyetimit gjyqësor, nëpërmjet të cilit gjykata arrin në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Në mënyrë që përfundimi i gjykatës të jetë i mbështetur, arsyetimi i vendimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar.

19. Gjykata vlerëson se mungesa e argumentimit ligjor, në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, në lidhje me përmbushjen e elementëve subjektivë të veprës penale, përbën një të metë të pakapërcyeshme të arsyetimit të gjykatës. Nga leximi integral i vendimit Gjykata vëren se, rrjedha logjike e përdorur në arsyetim nuk është e qartë dhe e kuptueshme; argumentet e pjesës arsyetuese nuk janë të lidhura logjikisht dhe nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për pasojë, në kushtet e mungesës argumentative që vihet re në arsyetim, edhe silogjizmi ligjor, mbi të cilin mbështetet vendimi, është i mangët.

20. Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet të vërë theksin te rëndësia që merr arsyetimi, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një vendim penal dhe sidomos kur gjykata e apelit ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nuk mund të vihet në dyshim rëndësia parësore që ka arsyetimi në një vendim penal. Për shkak të natyrës së tyre, llojeve të dënimit, dhe pasojave që sjellin për të pandehurin, vendimet penale duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë tërësore, mbi bazën e provave dhe argumenteve ligjore bindëse, të cilat mbështesin pjesën urdhëruese të vendimit. Sipas qëndrimit të Gjykatës, arsyetimi është kusht themelor për vlefshmërinë e vendimit penal dhe për drejtësinë e tij *(shih vendimet nr. 14, datë 3.5.2011; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Po në këtë këndvështrim, Gjykata nënvizon detyrimin që ka gjykata e apelit për të arsyetuar vendimin gjyqësor në mënyrë të qartë dhe të detajuar, veçanërisht në rastet kur ajo e ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nëse gjykata e apelit e lë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, arsyetimi edhe mund të jetë minimal apo i reduktuar, ndërsa kur ajo e ndryshon vendimin, është e detyruar të paraqesë dhe të shtjellojë në mënyrë të plotë argumentet ligjore, si pasojë e të cilave ka arritur në një vendimmarrje të ndryshme nga gjykata më e ulët.

22. Gjykata vëren se kërkuesja e ka ngritur pretendimin e mosarsyetimit të vendimit të gjykatës së apelit edhe në Gjykatën e Lartë. Kjo gjykatë nuk e ka vlerësuar dhe nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me këtë pretendim të kërkueses. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i cenueshëm, në kushtet kur është konstatuar cenimi i standardit të arsyetimit dhe Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar vendimin e gjykatës së apelit në këtë aspekt.

23. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimet, objekt shqyrtimi, nuk kanë respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Arsyet që e kanë çuar Gjykatën në këtë përfundim nuk lidhen me mosarsyetimin e vendimit në mënyrën e duhur apo bindëse, por me

mosplotësimin e kritereve bazë të arsyetimit, që duhet të përmbushë një vendim gjyqësor, në kuptimin kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve, paanësisë në gjykim dhe të drejtës së mbrojtjes

24. Kërkuesja ka pretenduar, *inter alia*, cenim të parimit të barazisë së armëve, paanësisë në gjykim dhe të së drejtës së mbrojtjes. Në mbështetje të këtyre pretendimeve ajo ka parashtruar se: në vendimin e gjykatës së apelit nuk argumentohet pse pretendimet e mbrojtësit janë të papranueshme dhe pse provat e akuzës janë të plota e të sakta; gjykata e apelit e ka bazuar vendimin në prova të marra në kundërshtim me ligjin, konkretisht në një ekspertim grafik të pavlefshëm si pasojë e mosnjoftimit të kërkueses për ekspertimin dhe mosdhënies së mundësisë për t'i bërë pyetje ekspertit (neni 179/2 i KPP-së), mungesës së vendimit të motivuar të organit procedues për ekspertimin (neni 182 i KPP-së), dhe mosbërjes së betimit nga eksperti (neni 183 i KPP-së); janë kryer veprime arbitrare nga oficerët e policisë gjyqësore lidhur me marrjen e akteve në zyrën e kërkueses, në shkelje të nenit 32/2 të Kushtetutës.

25. Gjykata ka theksuar se, veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementët më thelbësorë të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këto standarde kushtetuese kërkojnë që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen ashtu si ato të prokurorit dhe presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër. Synim kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi *(shih vendimet nr. 4, datë 10.2.2012; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 23, datë 23.7.2009 dhe nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata është shprehur se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve *(shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 5, datë 17.2.2003 dhe nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Gjykata ka pranuar në vazhdimësi se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që, në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast palët në gjykim. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e tij *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2010 dhe nr. 12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Bazuar mbi standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se, argumenti i kërkueses, në drejtim të mungesës së arsyetimit të gjykatës në lidhje me mospranimin e pretendimeve të mbrojtësit të saj, nuk qëndron. Gjykata, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, është shprehur se, gjykatat kanë detyrim të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument apo pretendim të palëve *(shih vendimin nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Për sa i përket vlerësimit material të provave, që është parashtruar nga kërkuesja edhe si rrethanë për njëanshmërinë e gjykatës së apelit, Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar mbi bazën e të cilit, interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Pranimi dhe vlerësimi i provave, si rregull, bëhet nga gjykatat e zakonshme ndërsa, për sa i përket mënyrës së marrjes së provave, detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në

tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt *(shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Nga aktet e dosjes gjyqësore Gjykata konstaton se, në datën 5.4.2008, kërkuesja është njohur me materialet e çështjes, ku përfshihet dhe akti i ekspertimit nr. 767, datë 5.2.2008, si dhe përfundimin e hetimeve nga ana e prokurorisë. Sipas procesverbalit të Policisë Gjyqësore Lezhë për sekuestrimin e provës materiale, të datës 3.2.2008, rezulton se sekuestrimi i provave materiale në zyrën e kërkueses është bërë në përputhje me nenin 300/2 të KPP-së, në kushtet e rrezikut të ndryshimit apo humbjes së gjurmëve dhe sendeve. Po në këtë kontekst, edhe procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së provës materiale në zyrën e kërkueses është bërë në prani të saj. Ekspertimi grafik është kryer nga Instituti i Policisë Shkencore, sipas vendimit të datës 4.2.2008 të Policisë Gjyqësore, e cila, në bazë të nenit 30 të KPP-së, *edhe me iniciativën e vet,* kryen hetime dhe grumbullon gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 14.1.2009 rezulton, gjithashtu, se avokatit të kërkueses, në funksion të realizimit të mbrojtjes, i është dhënë mundësia të pyesë ekspertin SH. K., i cili ka dhënë sqarime në lidhje me procedurën e caktimit të ekspertit, si dhe mbi konkluzionin e aktit të ekspertimit.

31. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses, për cenimin e parimit të barazisë së armëve, paanësisë në gjykim dhe të drejtës së mbrojtjes, janë të pambështetura.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

32. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se i është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se, ndonëse rekursi ka qenë i përpiluar në pajtim me kërkesat ligjore dhe në të janë paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka pranuar rekursin.

33. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se "Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14 datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Për natyrën e gjykimit në dhomë këshillimi, Gjykata është shprehur se sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri seleksionues të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Latë. E gjithë veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj *(shih vendimin nr. 4, datë 25.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Gjykata vëren, në rastin konkret, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit ka bërë vlerësim mbi ekzistencën e shkaqeve të parashtruara në rekurs, duke arritur në përfundimin se shkaqet e pretenduara nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Mbështetur në këtë vlerësim dhe, bazuar në nenin 433 të KPP-së, që parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

36. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal nuk i ka cenuar, në thelb, kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë.

37. Si përfundim, bazuar në çka më sipër, Gjykata çmon se ndodhet përpara cenimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë[1].
- Dërgimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për këtë çështje, jam i mendimit se duhej shfuqizuar vetëm vendimi nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sepse nuk respekton standardet minimale të arsyetimit të një vendimi gjyqësor.

2. Shumica ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit). Sipas shumicës, ky vendim (kupto: vendimi i Gjykatë së Lartë) është i cenueshëm në kushtet kur është konstatuar cenimi i standardit të arsyetimit dhe Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar vendimin e gjykatës së apelit në këtë aspekt *(prg.22 i vendimit),* prandaj dhe ajo ka konkluduar për shfuqizimin e të dyja vendimeve, si për vendimin e gjykatës së apelit ashtu dhe për vendimin e Gjykatës së Lartë.

3. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e veçanërisht në çështjet kundër Shqipërisë, është shprehur se arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element i të drejtës për një proces të rregull ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në çdo rast, vendimi gjyqësor duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. (…) Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 8, datë 16.3.2011)*.

4. Në çështjen Marini kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja ka theksuar se: *"arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës" (prg.106). Ky qëndrim është mbajtur dhe nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve)*.

[1] Kryetari votoi "pro" pranimit të kërkesës vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

5. Megjithatë, KEDNJ-ja, si instrument i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ofron vetëm një standard minimum të mbrojtjes së të drejtave dhe shtetet nuk pengohen të shkojnë përtej këtij kufiri (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 38/2003, 24/2007; nr. 12/2010)*. Pra, edhe nëse këto vendime de plano të Gjykatës së Lartë janë konsideruar si të pajtueshme me standardet e nenit 6 të KEDNJ-së, ky përfundim nuk e pengon Gjykatën Kushtetuese të ofrojë një standard të ri në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë. Edhe vetë GJEDNJ-ja, me vendimet e saj de plano për mospranimin e aplikimeve, edhe pse shkurtimisht, gjithsesi reflekton një minimum arsyetimi që nuk ka të inkorporuar vetëm bazën konventore *(shih vendimet de plano të GJEDNJ-së mbi papranueshmërinë e aplikimeve)*.

6. Mendoj se formulat e ligjit të përdorura nga Gjykata e Lartë nuk janë arsyetime, sepse referenca në ligj nuk zëvendëson arsyetimin. Duke përmendur vetëm dispozitën ligjore, inteligjenca dhe logjika e gjyqtarit zëvendësohet me atë të ligjvënësit. Për më tepër, nuk është detyra e gjyqtarit kushtetues t'i hyjë analizës ligjore të pretendimeve të parashtruara në rekurs, por një gjyqtar kushtetues i lejon vetes të shqyrtuarit e pretendimeve, deri aty sa të shprehet se ato janë rilevante *prima facie* dhe për to rekursuesi meriton një minimum përgjigjeje të argumentuar, nisur edhe nga natyra e çështjes. Nëse Gjykata e Lartë shprehet se rekursi nuk mund të pranohet, sepse nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara me ligj, është e pamundur të kuptohet nga rekursuesi se kjo gjykatë thjesht e ka shpërfillur rekursin e tij, apo ka analizuar shkaqet e paraqitura dhe ka dalë në konkluzionin se ato nuk janë të tilla që ligji i kërkon, apo janë haptazi të pabazuara/ nuk qëndrojnë.

7. Në rastin konkret, në mënyrë të përmbledhur, konstatoj se kërkuesja ka pretenduar në rekurs se vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar, se kjo gjykatë ka marrë prova në kundërshtim me ligjin dhe se kjo gjykatë ka zbatuar gabim ligjin material penal.

8. Mendoj se *prima facie* rekursi përmbante shkaqe nga ato që janë objekt shqyrtimi sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së. Nisur dhe nga natyra e çështjes dhe nga kategoria e pretendimeve të parashtruara, duke referuar vetëm dispozitën ligjore, pra nenin 432 të KPP-së, Gjykata e Lartë nuk plotëson kriterin "minimum arsyeje" që mund të ishte shkak i mospranimit të rekursit. Prandaj, dhe vendimit nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i mungon arsyetimi, duke cenuar të drejtën e kërkueses për proces të rregullt ligjor.

Kryetar: Bashkim Dedja

MENDIM PAKICE

1. Gjykata ka pranuar pretendimet e kërkueses dhe ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 323, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe vendimin nr. 00-2012-76, datë 2.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit. Shumica, ka arritur në përfundimin se *"vendimet, objekt shqyrtimi, nuk kanë respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Arsyet që e kanë çuar Gjykatën në këtë përfundim nuk lidhen me mosarsyetimin e vendimit në mënyrën e duhur apo bindëse, por me mosplotësimin e kritereve bazë të arsyetimit, që duhet të përmbushë një vendim gjyqësor, në kuptimin kushtetues" (shih § 23 të vendimit)*.

2. Argumentet e shumicës për të gjetur elementët e mungesës së arsyetimit të vendimit të gjykatës së apelit, ne gjyqtarët në pakicë, i gjejmë të sforcuara dhe mendojmë se vijnë në kundërshtim me kriteret dhe qëndrimet e mbajtura deri më tani në jurisprudencën e kësaj Gjykate.

3. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete për zgjidhjen e tyre, si dhe vlerësimi i fakteve, rrethanave dhe provave nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011 dhe nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

4. Shumica ka pranuar pretendimet e kërkueses duke arsyetuar, në thelb, se Gjykata e Apelit Shkodër, në vendimin e saj, nuk ka analizuar elementët e veprës penale dhe më konkretisht, anën subjektive të saj, si dhe nuk ka verifikuar ekzistencën e këtyre elementëve, fakt, i cili ka passjellë cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit. Sipas shumicës, detyrë e gjykatës së apelit, në rastin në shqyrtim, ka qenë të vlerësonte provat, sipas kritereve ligjore, duke shpjeguar në arsyetim rezultatet e arritura provuese mbi bazën e të cilave të vërtetohej ekzistenca e elementëve objektivë dhe subjektivë të veprës penale (shih § 18 të vendimit). Po ashtu shumica ka vlerësuar se rrjedha logjike e përdorur në arsyetim në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, nuk është e qartë dhe e kuptueshme; argumentet e pjesës arsyetuese nuk janë të lidhura logjikisht dhe nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme (shih § 19 të vendimit).

5. Lidhur me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, Gjykata, sikurse thekson edhe shumica, është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Me anë të arsyetimit të vendimit gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve *(shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithsesi, Gjykata e ka zbatuar këtë parim rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke vlerësuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka vlerësuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendur. Në këtë kontekst, detyrimi që kanë gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 35, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

6. Në vlerësimin tonë, në rastin objekt shqyrtimi, ndryshe nga sa argumenton shumica, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë i paarsyetuar, në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës dhe të Kodit të Procedurës Penale, të ketë kundërthënie, të jetë alogjik apo të jetë thjesht formal. Gjykata e apelit ka analizuar dhe shqyrtuar të gjitha rrethanat e çështjes, provat e paraqitura, i ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve dhe ka parashtruar në vendim argumentet për deklarimin fajtore të kërkueses, duke plotësuar kushtin e ekzistencës së kritereve bazë të arsyetimit të vendimit.

Nga ana tjetër, kërkimi dhe gjetja e elementëve objektivë dhe subjektivë të veprës penale kryhet mbi bazën e bindjes së brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim si pasojë e administrimit të drejtpërdrejtë të provave në gjykim dhe si i tillë, ky kërkim, hyn në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, në rastin në shqyrtim, jemi të mendimit se nuk është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit.

8. Si përfundim, ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara dhe për rrjedhojë duhej vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.12.2012
Doli nga shtypi më 26.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Gurten"
Tiranë, 2012

Çmimi 22 lekë